KËRKESË
Nr. 2551, datë 6.3.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti "Krijimi i qendrave të fshatrave me sipërfaqe qëndrimi, pushimi, parkimi dhe lulishte në fshatin Mbrakull", Poliçan.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Poliçan.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personin e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë e paluajtshme, pronë private, e cila do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" dhe në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,664,617 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Artan Shkreli

Lista e shpronësimit të pronarëve të pasurive pronë private që preken nga realizimi i projektit:
"Krijimi i qendrave të fshatrave me sipërfaqe qëndrimi, pushimi, parkimi dhe lulishte në fshatin Mbrakull", Poliçan

Nr.	Emër Mbiemër	Zona Kadastrale	Nr/pasurisë	Sipërfaqja totale (m^2)	Sipërfaqe shpronësimi			Çmimi (lekë)		Vlera e tokës Arë (lekë)	Vlera e tokës Truall (Arë)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera totale / Lekë	Shënime Konfirmuar ose jo nga nga ZVRPP-ja
					Tokë Arë (m^2)	Tokë Truall (m^2)	Sip. Ndërtese (m^2)	Tokë Arë/m^2	Tokë Truall /m^2					
1	Kosta Ilias Mile	2632	100/16	500	250	250	80	203	189	50750	47250	1,566,617.00	1,664,617.00	Konfirmuar nga ZVRPP
Vlera totale e shpronësimit													1,664,617.00	